



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Extreme Clean" Sh.P.K. të datës 23.10.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 17.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-4576-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Extreme Clean" Sh.P.K. e datës 20.10.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 17.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-4576-2-1-1 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 17.10.2023 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Extreme Clean" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Extreme Clean" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 20.10.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 17.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-4576-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: “ Sipas kesaj tabele eshte e pamundur qe ndrrimet e nates te mbahen me nje punetor andaj te keto ndrrime duhet te llogariten se paku 4 punetore meore shtese nate, kurse OE fitues I ka llogaritur vetem 3, poashtu numrin e diteve e ka shkurtuar per nje dite ka llogaritur vetem 21 dite sipas ligjit 176 ore / 22 dite= 8 ore, apo $22 \cdot 8 = 176$ ore, dhe gabimi eshte 1 dite per cdo muaj ne dite e krejt kjo ka rezultuar qe cmimi i ketij OE te jete me i lire ne krahasim me ofertat e pergjegjeshme financiare, andaj kete veprim te OE duhet AK ta analizonte mire dhe ta hudhte oferten si te papergjegjshme financiarisht sepse nuk I mbulon shpenzimet e oreve te nates dhe vikendeve bazuar ne ligjin e punes 03 / L – 212”.

Lidhur me pretendimet ankimore është gjetur se komisioni vlerësues në raportin e vlerësimit nuk ka kërkuar / ofruar sqarime lidhur bazën e kalkulimit të ofertës financiare të tenderuesit të rekomanduar. Duke marrë parasysh pretendimin ankimor atëherë komisioni përkatës me rastin e rivlerësimit duhet të kërkoj sqarimet e nevojshme lidhur me këtë kërkesë të dosjes së tenderit sipas nenit 59 paragrafit 2 të LPP. Varësisht nga sqarimet e ofruara, komisioni duhet të veproj në përputhje me parimin për trajtimin e barabartë të gjithë tenderuesve në kuptim të nenit 7 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Në këtë mënyrë është gjetur se komisioni vlerësues nuk pra vepruar në përputhje me nenin 59 të LPP dhe 40 të RRPP. Për këto arsye është miratuar si e bazuar pjesërisht kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 30.10.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.